



KOLEGJI
UNIVERSUM

**Grupi:
Ambasadorët e
Kolegjit Universum**

Ambasadorët e Universum-it

1. Qëllimi: Të njoh studentët e dalluar dhe të inkuadroj ata në zhvillimin e mësimnxënjes dhe përparimin e studentëve në klasë. Ambasadorët do të jenë përfaqësues, këshillues dhe ndihmues për bashkëkolegët, përmes ofrimit të seanceve të mentorimit dhe këshillimit. Anëtarësimi është i përjetshëm, dhe mund të ketë status Aktiv, Alum, dhe Alum i Dalluar.

2. Nominimet e Studentëve: Studentët që shfaqin aftësi të dalluara akademike do të emërohen nga profesorët e tyre, apo studentët mund të aplikojnë. Studentë të nominuar automatikisht do të jenë pjesë e grupit Ambasadorët e Universum-it, ndërsa aplikantët do të shqyrtohen nga një grup i profesorëve.

2.1. Për t'u bërë pjesë e grupit Ambasadorët e Universum-it, një student duhet të posedojë, apo të jenë të përafërta, me këto aftësi dhe karakteristika:

2.1.1. Studenti i përzgjedhur duhet të shfaq aftësi të dalluara akademike

2.1.2. Studenti duhet të ketë notën mesatare mbi nente (9)

2.1.3. Studenti duhet të ketë aftësi të shkëlqyera komunikuese (në të shkruar dhe në të folur), për arsye se ai/ajo do të përfaqësojnë, këshillojnë dhe ndihmojnë studentët apo bashkëkolegët e tyre

2.1.4. Studenti i përzgjedhur duhet të shfaq aftësi lidërshipi dhe bashkpunuesi

2.2. Secila lëndë do të ketë përfaqësuesit e tyre në Ambasadorët e Universum-it

2.2.1. Secili profesor mund të zgjedh maksimum dy (2) përfaqësues nga një lëndë, ku studentët e përzgjedhur duhet të kenë aftësitë e lartpërmendura në pikën 2.1. Përfaqësuesit mund të ngriten në tre

(3) në rast se një student gjatë semestrit shfaq interesime dhe aftësi me të mëdha akademike.

2.2.2. Një student mund të perzgjedhet që të perfaqesoj deri në tre (3) lëndë të një programi akademik

2.2.3. Do të krijohet një liste me studentët perfaqesues të Ambasadorët e Universum-it dhe do të mirembahet nga vete të perzgjedhurit e Ambasadorët e Universum-it.

2.3. Menaxhimi i Ambasadorëve të Universum-it

2.3.1. Do të ketë një koordinator per secilën njësi (kampus) akademike.

2.3.2. Do të ketë autonomi të plotë menaxhuese, me përjashtim të delegimit dhe shkarkimit të studentëve në grup. Ketë e bën secili profesor për secilen lëndë.

2.3.3. Duhet të ju përmbahet pikës 2.2.3.

3. Përgjegjësitë: Studentët Ambasador do të caktohen në një lëndë për një semestër me mundësi vazhdimi bazuar në vendimin e profesorit të lëndës.

3.1. Përgjegjësitë specifike janë si më poshtë:

3.1.1. Mbajtjen e seancave të hapura të tutorimit për të gjithë studentët e klasës çdo dy javë, në një orar të përshtatshëm për shumicën e studentëve. Këto sesione do të mbulojnë materiale të dy javëve të mëparshme të ligjëratave.

3.1.2. Mbajtjen e takimeve individuale me studentët të identifikuar nga profesori i lëndës për ngecje në mësim.

3.1.3. Të përgjigjurit me e-mail në pyetjet e studentëve rreth materialit mësimor, mundësisht brenda 48 orëve nga marrja e e-mailit.

3.1.4. Krijimin e një rrjeti social për lëndën që perfaqeson, dhe mirembajtjen e saj

- Studentët Ambasador janë përgjegjës për krijimin e faqes në një rrjet social (me pëlqimin e profesorit), si dhe komunikimin me kolegët për inkuadrimin e tyre.
- Studentët Ambasador duhet të postojnë një herë në javë në faqen e rrjetit social të perzgjedhur, me këshilla përkatëse për materialin e mbuluar gjatë ligjëratave.
- Përveç kësaj, kjo faqe do të përdoret për të njoftuar rreth orarit të seancave të tutorimit si dhe për rishikim të provimeve.
- Faqja e rrjetit social do të monitorohet nga profesorët për të siguruar cilësinë në mësimdhënie dhe tutorim.

3.1.5. Aranzhimi i diskutimeve javore përmes rrjeteve sociale (Lore, Google +, Blogs, Google Sites, Twitter, Facebook, etj) në lidhje me tema të kursit, në bashkpunim me profesorin e lëndës.

3.1.6. Shërben si një ndërlidhje në mes të studentëve dhe profesorit në lidhje me shqetësimet eventuale.

3.1.7. Aranzhimi i diskutimeve, grupeve mesimore dhe aktiviteteve të ndryshme.

3.1.8. Merr pjese nëpër ligjerata publike që organizon Kolegji Universum

4. Përfitimet: Studentët Ambasador do të marrin një certifikatë dhe mirënjohje, dhe anëtarësim të përhershëm

4.1. Mbi të gjitha përparësia e pjesëmarrjes si Ambasador është njëpërvojë qëdo tu shërbej studentëve për karierrë dhe avantazh në kontakt me punëdhënësit potencialë.

4.2. Për me tej, studentët Ambasador që përmbushin të gjitha përgjegjësitë do të marrin letër rekomandime nga profesori përkatës, dhe Alum i Dalluar.

4.3. Studentët Ambasador do të kenë perparësi në dhenjen e Internshipeve nga Zyra e Karrieres në Kolegjin Universum

- 4.4. Ambasadorët mund të marrin pjese nëpërtë gjitha aktivitetet e Kolegjit Universum, si p.sh. Ligjeratat Publike jashtë kolegjit
- 4.5. Ambasadorët, nëse janë permbajtur me perpikmeri përgjegjësive të tyre, do të konsiderohen për zbritje në pagesat shkollore.
- 4.6. Ambasadorët mund të jene prezentues nëpër evinimente të ndryshme, ligjerata publike, etj, të cilat i organizon Kolegji Universum.
- 4.7. Ambasadorët mund të marrin pjesë në evenimente të ndryshme të organizuara nga Unviersumi me çmime të njëjta sikurse stafi i Universum-it.

5. Përgjegjësitë e profesorëve:

- 5.1. Profesori përzgjedh studentin/studentët Ambasador – Profesori duhet të përzgjedhë ata në bazë të pikës 2, 2.1 dhe 2.2.
- 5.2. Profesorët do të takohen me Studentët Ambasador një herë në çdo dy javë për të diskutuar rreth seancave të tutorimit.
- 5.3. Gjatë këtyre takimeve, profesorët do të trajtojnë përmbajtjen, problemet, të kuptuarit e nxënësve, reagimet, si dhe çdo çështje tjetër që studentët perfaqesues mund të kenë nevojë për ti diskutuar, keshilluar bashkeleget e tyre.
- 5.4. Profesori do të sigurojë materialet e nevojshme studimore për të asistuar Studentin perfaqesues gjatë tutorimit apo ndihmes që ai/ajo jep bashkekolegeve.
- 5.5. Profesori do të marrë pjesë në një sesion studimor gjatë semestrit për të monitoruar dhe udhëzuar Studentin perfaqesues.
- 5.6. Profesori mund të shkarkon studentët Ambasador në rast se ata nuk janë në gjendje të përmbahen detyrave dhe përgjegjësive të tyre.

6. Vendimi:

- 6.1. Ky organizim duhet të fillon nga semestri pranveror, sipas kalendarit akademik të Kolegjit Universum
- 6.2. Të gjithë profesorët e lendeve duhet të perzgjedhin studentët Ambasador mbrenda 3 javeve të fillimit të semestrit
- 6.3. Emrat e përzgjedhësve duhet të dërgohen tek koordinatori i Ambasadorëve te kampusit – të cilet do të perzgjedhen se shpejti dhe do të ju njoftojnë
- 6.4. Studentët e përzgjedhur mund të jenë të njohur nga profesorët ngase ata ishin student të tyre.

Studentët Koordinator për mbarvajtjen e grupit 'Ambasadorët e Kolegjit Universum' janë:

- Ylberina Murseli - Prishtinë (ylberinamurseli@universum-ks.org)
- Shqipe Livoreka - Ferizaj (shqipelivoreka@universum-ks.org)
- Ardita Kasemi - Prizren (arditakasemi@universum-ks.org)
- Rrezart Dema - Gjakovë (rrezartdema@universum-ks.org)

Për më shumë informata, mund të kontaktoni me stafin:

- Alban Asllani
- Mergim Cahani
- Arlinda Berisha
- Ridvan Peshkopia
- Festina Balidemaj
- Uran Rraci